



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**  
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. 2020

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

**1 (një) Specialist Ekonomist/e në Sektorin e Financë-Administratës, pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.**

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbush kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zoterojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënues për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi Civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Diplomë në Ekonomi;
- Të jetë pajisur me diplomën përkatëse;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh (dëshmi, certifikata);
- Aftësi komunikuese dhe pune në grup;
- Eksperiencë pune;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, **brenda datës 01.10.2020**, këto dokumenta;

- Kërkesë për punësim;
- Jetëshkrimi i plotësuar ( CV);
- Diplomë e noterizuar ( për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhësi nga Ministria e Arsimit);
- Diplomë Master e noterizuar;
- Listë notash e noterizuar;
- Çertifikatë kompjuteri;
- Çertifikatë familjare;
- Dëshmi për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar ;

- Librezë Pune ;
- Kartë identiteti (fotokopje) ;
- Dëshmi penaliteti ( të datojë brenda 3 muajve të fundit) ;
- Raport mjekësor për aftësi në punë.

**Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.**

**Adresa: Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë . Rruga: “Him Kollit” Tel. +35544532411. E - mail:tirane@fsdksh.com.al  
Web://www.fsdksh.com.al**